



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

**RREGULLORE (QRK) NR 12/2024 PËR MBROTJEN E INFORMACIONIT
TË KLASIFIKUAR NË FUSHËN INDUSTRIALE¹**

¹Rregullore (QRK) Nr. 12/2024 për Mbrotjen e Informacionit të Klasifikuar në Fushën Industriale, është aprovuar në mbledhjen e 203-të, të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 03/203, datë 08.05.2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, dhe nenin 8, paragrafi 4, nën-paragrafi 4.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 19, paragrafi 6, nën-paragrafi 6.2 të Rregullores Nr.09/2011 së Punës së Qeverisë,

Nxjerr:

RREGULLORE NR. 12/2024 PËR PROCEDURAT PËR MBROTJEN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR NË FUSHËN INDUSTRIALE

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i procedurave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar në fushën industriale.
2. Kjo rregullore është në harmoni me legjislacionin e BE-së, si në vijim:

2.1. Vendimin e Këshillit të 23 shtatorit 2013 mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet vetëm për rastet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Rregullat e parashikuara janë të zbatueshme nga autoriteti kombëtar për sigurinë e informacionit të klasifikuar, operatorët ekonomikë të interesuar, si dhe çdo institucion tjetër shtetëror, i cili:

2.1. Përfshihet në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, në cilësinë e autoritetet kontraktues apo edhe të institucionit përfitues;

2.2. Merr pjesë në kryerjen e procedurave të verifikimit të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë financiare të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **“Pyetësi i Sigurisë Industriale”**, është dokumenti që e plotëson operatori ekonomik, tërësia e kërkesave në bazë të të cilave vlerësohet nëse një operator ekonomik plotëson kriteret për t’u pajisur me Certifikatë të Sigurisë Industriale;

1.2. **“Brifimi”/”Debrifimi”** - janë tërësi instruksionesh dhe udhëzimesh sigurie lidhur me procedurat e sigurimit të informacionit të klasifikuar dhe përgjegjësitë individuale për shkeljet e rregullave të sigurisë, të cilave u nënshtrohen personat që kërkojnë të kenë mundësinë për njohje me informacionin e klasifikuar ose janë të pajisurë me CSP dhe CSI;

1.3. **“Udhëzuesi i sigurisë së projektit”** - tërësia e rregullave dhe procedurave të sigurisë, të detyrueshme, për t’u zbatuar në projektin specifik të kontratës të klasifikuar;

1.4. **“Plani i sigurisë së ngarkesës”** - dokumenti i miratuar nga autoriteti kontraktues, ku përfshihen masat, që garantojnë sigurinë e transportit të materialit të klasifikuar;

1.5. **“Vizitat”** - të cilat bëhen në kuadër të detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, pas një kërkesë nga autoriteti kompetent i njëjës palë ose në bazë të një ftese, nga autoriteti kontraktues;

1.6. **“Vizitorë”** - përfaqësuesit zyrtarë të një shteti apo organizate ndërkombëtare, që, në bazë të detyrave zyrtare, kërkojnë të vizitojnë objektet e kontraktuesit;

1.7. **“Person”** - nënkupton personin fizik apo juridik;

2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me ato të përdorura në Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.

Neni 4 Parimet e Përgjithshme

1. Operatori ekonomik i interesuar për të marrë pjesë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar në nivelin “SEKRET” dhe “Konfidencial”, duhet të jetë i pajisur më parë me nivelin e kërkuar të Certifikatës së Sigurisë Industriale (CSI).

2. Në çdo prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar në nivelin “SEKRET” dhe “KONFIDENCIAL”, personeli që përfaqëson operatorin ekonomik dhe personat e tjerë që do të kenë qasje tek informacioni i klasifikuar, duhet të jenë të pajisur me nivelin e kërkuar të Certifikatës së Sigurisë së Personelit (CSP), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Angazhimi i konsulentëve, audituesve dhe ekspertëve të ndryshëm për llogari dhe në interes të palëve, është i mundur në çdo prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, vetëm kur çdo njeri prej tyre:

3.1. sigurojnë të drejtën e njohjes nga titullari i institucionit ose Zyrtari i Sigurisë Industriale të Kontraktorit për shkak të detyrës që kryejnë;

3.2. janë të informuar / brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive individuale për shkeljet e sigurisë dhe të ketë nënshkruar deklaratën e ruajtjes së informacionit;

3.3. respekton të njëjtat standarde dhe kërkesa të sigurisë, të përcaktuara nga autoriteti kontraktues, operatori ekonomik e sipas rastit edhe nga institucioni përfitues;

3.4. Për rastet e njohjes me informacion të klasifikuar në nivelin “KONFIDENCIAL”, “SEKRET”, është i pajisur më parë me CSP të vlefshme.

Neni 5 **Niveli dhe tipet e CSI**

1. AMIK-u është autoritet për lëshimin e CSI në nivelin “KONFIDENCIAL” dhe “SEKRET”.
2. Kur ekzistojnë rrethana të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, AMIK, lëshon edhe CSI për njohjen e informacionit të klasifikuar të NATO-s e BE-së, në një nga nivelet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 6 **Afati i vlefshmërisë së CSI-së**

1. CSI e lëshuar nga AMIK vlenë për periudhën pesë (5) vjeçare nga data e lëshimit të saj.
2. Zgjatja e afatit të CSI-së, bëhet përshtatshëm me zgjatjen e afatit të CSP-së.
3. CSI mund të revokohet përpara mbarimit të afatit të lëshimit, kur ekzistojnë rrethanat e përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 7 **Vlefshmëria e CSI-së**

1. CSI e lëshuar nga AMIK është e vlefshme:
 - 1.1. Vetëm për qasje tek informacioni i klasifikuar;
 - 1.2. Për qasje, të drejtën e ruajtjes dhe të administrimit të informacionit të klasifikuar në hapësirat e operatorit ekonomik;
 - 1.3. Për qasje, të drejtën e ruajtjes dhe të administrimit të informacionit të klasifikuar, si dhe përdorimit të sistemeve të akredituara të komunikimit dhe të informacionit në hapësirat e operatorit ekonomik.

Neni 8
Kriteret bazë të operatorit ekonomik për qasje tek informacioni i klasifikuar

1. Operatori ekonomik ka të drejtën për qasje tek informacioni i klasifikuar, vetëm kur:
 - 1.1. posedon CSI të vlefshme, të konfirmuar nga autoriteti përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar.
 - 1.2. zyrtari i sigurisë ka brifuar më parë personelin e pajisur me CSP për procedurat e sigurisë dhe përgjegjësitë.
 - 1.3. qasja tek informacioni i klasifikuar është në kushtet e zbatimit të parimit “nevojë për të ditur”.
 - 1.4. autoriteti kontraktues dhe sipas rastit institucioni përfitues që posedon informacionin e klasifikuar i ka ofruar operatorit ekonomik të interesuar kushte normale pune në hapësirat e tij, brenda zonave të sigurisë.

Neni 9
Kriteret për qasje, ruajtje dhe administrim të informacionit të klasifikuar në hapësirat e operatorit ekonomik

1. Ka të drejtën për qasje, ruajtje dhe administrim të informacionit të klasifikuar në hapësirat e tij, çdo operator ekonomik, kur:
 - 1.1. plotëson kriteret e parashikuara të nenit 8 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.2. ka të ngritur strukturën e sigurisë së brendshme e cila nën mbikëqyrjen e zyrtarit të sigurisë, është përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
 - 1.3. institucioni që posedon informacionin e klasifikuar, ka dhënë pëlqimin me shkrim, adresuar AMIK;
 - 1.4. AMIK ka bërë konfirmimin me shkrim për autoritetin kontraktues dhe operatorin ekonomik, pasi më parë ka verifikuar përmes inspektimit të drejtpërdrejtë të sigurisë, se operatori ekonomik i plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për administrimin e informacionit të klasifikuar në hapësirat e tij, brenda zonave të sigurisë.

Neni 10
Konfirmimi i vlefshmërisë së CSI-së dhe CSP-së

1. AMIK njeh dhe konfirmon afatin e vlefshmërisë, nivelin dhe tipin e CSI-së e CSP-së të cilat janë lëshuar nga një autoritet kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar të një vendi anëtar të NATO- s, BE, ose të një shteti me të cilin ka Marrëveshje të Sigurisë.

2. Autoriteti kontraktues ka përgjegjësinë për mbledhjen dhe adresimin e të dhënave të plota identifikuese tek AMIK, në funksion të konfirmimit të së kaluarës të CSI-së për operatorin ekonomik të huaj dhe të CSP-së për personelin e tij.
3. Njohja për afatin e vlefshmërisë, nivelin dhe tipin e CSI-së e CSP-së, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet vetëm pas korrespondencës zyrtare ndërmjet autoriteteve homologe.
4. AMIK, bën konfirmimin e së kaluarës për operatorët ekonomik që do të jenë pjesë e fazave të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar, duke i ofruar informacionin e kërkuar autoritetit kontraktues, lidhur me afatin e vlefshmërisë, nivelin, tipin e CSI-së, si dhe personelin e pajisur me CSP-së të përshtatshme.

Neni 11

Kushtet paraprake të aplikimit për CSI

1. Për pajisje me CSI për pjesëmarrje në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë i cili përmban informacion të klasifikuar, sipas mënyrave të përcaktuara në nenin 12 të kësaj Rregulloreje i pajisur me Numër Unik të Identifikimit (NUI), operatori ekonomik duhet të plotësojë të gjitha kushtet si në vijim:
 - 1.1. Të ketë strukturë organizative;
 - 1.2. Të paktën gjatë tre viteve të fundit rezulton me bilanc pozitiv, referuar pasqyrave financiare të vërtetuara nga Administrata Tatimore e Kosovës;
 - 1.3. Gjatë tre viteve të fundit nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik;
 - 1.4. Gjatë tre viteve të fundit nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmbajnë informacion të klasifikuar. Ky kusht konsiderohet i paplotësuar për operatorët ekonomik që janë në proces gjyqësorë për procedurë përjashtimi, deri në momentin kur gjykata kompetente të merr Vendim përfundimtar;
 - 1.5. Gjatë dhjetë viteve të fundit nuk i është refuzuar, revokuar Certifikata e Sigurisë Industriale (CSI);
 - 1.6. Rezulton i pajisur me licencën/at profesionale, në lidhje me veprimtarinë për të cilën është i regjistruar, vërtetuar me dokumentacion përkatës origjinal, ose të noterizuar.
 - 1.7. Nuk është në likuidim, në proces falimentimi apo në pritje të procedurave të falimentimit, vërtetuar me deklaratë noteriale të administratorit të operatorit ekonomik dhe me vërtetim të lëshuar nga Gjykata kompetente;
 - 1.8. Nuk rezulton në kushtet e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë, vërtetuar me deklaratë noteriale të administratorit të operatorit ekonomik;

1.9. Administratori, pronari / pronarët, operatori ekonomik nuk rezultojnë të dënuar, vërtetuar me dëshmi nga Gjykata kompetente;

1.10. Referuar vërtetimit të lëshuar nga Gjykata kompetente, rezulton se operatori ekonomik nuk është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm;

1.11. Operatori Ekonomik rezulton se i ka paguar tatimet, konfirmuar përmes vërtetimit të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës;

1.12. Operatori Ekonomik i cili ka kredi të marra në sistemin bankar, rezulton se i shlyen ato rregullisht, konfirmuar përmes vërtetimit të lëshuar nga Banka Qëndrore e Kosovës;

1.13. Operatori Ekonomik i cili ka marrë hua, rezulton se i shlyen ato rregullisht, konfirmuar përmes Deklaratës nën betim të Pronarit / Administratorit/ e noterizuar.

2. Konstatimi për mosplotësimin e një apo më shumë kriterëve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, përbën shkak të mjaftueshëm për mos fillimin apo ndërprerjen e menjëhershme të procedurave për pajisje me CSI.

Neni 12 **Mënyrat e aplikimit për CSI**

1. Aplikimi për pajisje me CSI i adresohet AMIK-ut. Mënyrat e aplikimit për t'u pajisur me CSI janë:

1.1. Me kërkesë të autoritetit kontraktues;

1.2. Me kërkesë të autoritetit kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar të një vendi anëtar të NATO-s, BE-së, ose të një vendi me të cilin ka Marrëveshje të Sigurisë;

1.3. Me kërkesë të autoritetit kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar të NATO-s, BE-së apo të një strukture tjetër brenda këtyre dy organizatave në cilësinë e autoritetit kontraktues;

1.4. Me kërkesë të drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik vendor, vetëm kur:

1.4.1. Operatori ekonomik i interesuar i plotëson të gjitha kushtet paraprake të parashikuara në paragrafin 1, të nenit 11 të kësaj Rregulloreje;

1.4.2. Operatori ekonomik i interesuar, gjatë 3 (tri) viteve të fundit ka qenë të paktën 1 (një) herë palë në një kontratë/nëkontratë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë e cila ka trajtuar informacion të klasifikuar, e vërtetuar me shkrim nga autoriteti kontraktues përkatës.

2. Aplikimi sipas nënparagrafëve 1.1., 1.2. dhe 1.3. të paragrafin 1 të këtij neni realizohet kur:

2.1. ekziston interesi për pjesëmarrje në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar, ose kur operatori ekonomik është në kushtet e zbatimit të kontratës/nëkontratës që përmban informacion të klasifikuar;

2.2. operatori ekonomik i interesuar plotëson të gjitha kushtet paraprake të parashikuara në paragrafin 1 të nenit 11 të kësaj Rregulloreje;

2.3. kërkesa për aplikim me CSI shoqërohet me dokumentacionin e aplikimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 13, të kësaj Rregulloreje.

Neni 13 **Dokumentacioni i aplikimit për pajisje me CSI**

1. Dokumentacioni i aplikimit për t'u pajisur me CSI, përmban:

1.1. Kërkesën për lëshimin e CSI-së, drejtuar AMIK-ut, sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga ky autoritet;

1.2. Pyetësin e Sigurisë Industriale dhe autorizimin për dhënien e pëlqimit për kryerjen e verifikimeve dhe ruajtjen e "informacionit të klasifikuar", sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga AMIK;

1.3. Certifikatën e biznesit për të dhënat e operatorit ekonomik;

1.4. Certifikatën e lëshuar nga Gjykata, që vërteton, se në drejtim të Operatorit Ekonomik nuk është i dënuar aktgjykim të plotfuqishëm për vepër penale;

1.5. Vërtetimin e lëshuar nga Oda e Përmbaruesve, që vërteton, se për kapitalet/asetet e operatorit ekonomik nuk ekziston një urdhër përmbarimi;

1.6. Vërtetimin e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, që vërteton, se operatori ekonomik i ka plotësuar detyrimet tatimore;

1.7. Vërtetimin e lëshuar nga Banka Qëndrore e Kosovës, që vërteton, nëse Operatori Ekonomik ka kredi të marra në sistemin bankar dhe i shlyen rregullisht ato.

2. Dokumentet e aplikimit, sipas këtij neni, duhet të jenë origjinale, të lëshuara nga autoritet përkatëse brenda tre muajve të fundit. Ato i adresohen AMIK, të shoqëruara me Pyetësorët e Sigurisë për verifikimin e personelit që do të njihet me informacionin e klasifikuar.

Neni 14 **Kriteret për fillimin e verifikimit të sigurisë**

1. Operatori ekonomik i cili ka aplikuar për t'u pajisur me CSI sipas kriterëve të parashikuara në këtë Rregullore, i nënshtrohet vijimit të procedurave të verifikimit të sigurisë, vetëm kur AMIK-u konstaton se:

1.1. operatori ekonomik i interesuar ka ofruar dokumentacionin e plotë të aplikimit dhe të gjithë informacionin e kërkuar, sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi;

1.2. operatori ekonomik i plotëson kushtet paraprake të parashikuara në paragrafin 1, të nenit 11, të kësaj Rregulloreje;

1.3. administratori i operatorit ekonomik ka dhënë pëlqimin me shkrim që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të sigurisë për operatorin ekonomik të interesuar, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi.

2. AMIK shqyrton kërkesën dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e pranimit të saj e adreson përgjigjen përkatëse tek institucioni shtetëror ose operatori ekonomik i interesuar.

Neni 15

Afati kohor për kryerjen e procedurave të verifikimit të sigurisë dhe për rastet e riaplikimit

1. Afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit të sigurisë zgjat deri në 120 (njëqind e njëzetë) ditë kalendarike. Ky afat fillon vetëm pas paraqitjes së plotë dhe konfirmimit në rrugë shkresore nga ana e AMIK.

2. Procedurat për verifikimin e sigurisë, mund të vijojnë tej afatit të përgjithshëm të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, në rastet kur:

2.1. Verifikimet kushtëzohen nga kryerja e procedurave në bashkëpunim me autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar të vendeve të tjera.

3. Në rastet kur gjatë zbatimit të kontratës, rezulton se kontraktori apo nënkontraktori i mbaron afati i vlefshmërisë së CSI-së, autoriteti kontraktues dhe sipas rastit institucioni përfitues, kanë detyrimin që në bashkëpunim me operatorin ekonomik të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje dhe ta adresojnë tek AMIK, jo më vonë se 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë kalendarike përpara se të mbarojë afati i vlefshmërisë së CSI.

4. Në rastet kur gjatë zbatimit të kontratës, kontraktori apo nënkontraktori rezulton operator ekonomik i huaj, të cilit i mbaron afati i vlefshmërisë së CSI-së, atëherë, autoriteti kontraktor dhe sipas rastit institucioni përfitues, kanë detyrimin që në bashkëpunim me operatorin ekonomik të huaj, të paraqesin informacionin e kërkuar tek AMIK, jo më vonë se 240 (dyqind e dyzetë) ditë kalendarike përpara se të mbarojë afati i vlefshmërisë së CSI-së dhe CSP-së. Pas marrjes së informacionit të plotë lidhur me të dhënat e operatorit ekonomik të huaj dhe personelit të tij, AMIK fillon korrespondencën zyrtare me autoritetin homolog për lëshimin e CSI-së e CSP-së dhe konfirmimin e të kaluarës përkatëse.

Neni 16

Objekti i verifikimit të sigurisë

1. Për një operator ekonomik që aplikon për pajisje me CSI, objekt i verifikimit të sigurisë është:

1.1. struktura e pronësisë dhe origjina e saj duke përfshirë filialet / degët;

1.2. aktiviteti i operatorit ekonomik;

- 1.3. partnerët e ngushtë vendor dhe të huaj;
- 1.4. qëndrueshmëria financiare;
- 1.5. përmbushja e detyrimeve financiare ndaj institucioneve shtetërore dhe palëve të treta;
- 1.6. aftësia, kapacitetet teknike, fizike dhe ato për sigurinë e informacionit të klasifikuar, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi, në rastet kur administrojnë informacion të klasifikuar brenda hapësirave të operatorit ekonomik;
- 1.7. personat që zotërojnë pronësinë e operatorit ekonomik;
- 1.8. administratori dhe personat e tjerë që janë pjesë e stafit menaxherial në momentin e aplikimit për pajisje me CSI;
- 1.9. punonjësit që do të kenë qasje tek informacioni i klasifikuar;
- 1.10. personat e propozuar nga administratori për detyrën e zyrtarit të sigurisë industriale dhe të zëvendësit të tij.

Neni 17 **Procedurat e verifikimit të sigurisë industriale**

1. AMIK kërkon informacion e nevojshëm me qëllim të verifikimit të sigurisë për operatorin ekonomik që ka aplikuar për t'u pajisur me CSI.
2. Titullarët e institucioneve shtetërore apo private kanë detyrimin që zyrtarisht, me shkrim, të ofrojnë të dhënat e kërkuara brenda 5 ditë pune nga data e kërkesës së paraqitur nga AMIK.
3. AMIK në bazë të nevojës e fton në intervistë personin që i nënshtrohet procedurës së verifikimit, kërkon prej tyre paraqitjen e dokumentacionit shtesë në funksion të verifikimit të sigurisë.
4. Pyetëtori i Sigurisë Industriale është Shtojcë e kësaj rregulloreje.

Neni 18 **Kriteret bazë për vlerësimin e rrezikut të papranueshëm të sigurisë**

1. Një operator ekonomik i interesuar për t'u pajisur me CSI nuk përbën rrezik të papranueshëm të sigurisë kur:
 - 1.1. Plotëson dhe zbaton kërkesat e përgjithshme të parashikuara në këtë Rregullore;
 - 1.2. Është financiarisht i qëndrueshëm;

1.3. Është i besueshëm për qëllime të sigurisë dhe posedon aftësinë dhe kapacitetet teknike për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

2. Nuk është financiarisht i qëndrueshëm një operator ekonomik i cili rezulton se:

2.1. Ka falimentuar apo është në likuidim, ka bërë marrëveshje me kreditorë, ka pezulluar aktivitetet e biznesit ose është në një situatë të ngjashme;

2.2. Është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit, ekziston një urdhër likuidimi apo administrimi të detyrueshëm;

2.3. Nuk ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagimin e taksave dhe të tatimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2.4. Rezulton se i është ndaluar të kryejë veprimtari tregtare;

2.5. Ka performancë negative biznesi të vërtetuar përmes 1 (një) apo më shumë bilanceve negative në 3 (tre) vitet e fundit të aktivitetit;

2.6. Bashkëpronarët janë në rrethana konfliktuale interesash ekonomiko- financiare lidhur me strukturën e pronësisë së operatorit ekonomik.

3. Operatorët ekonomikë mund të ofrojnë informacion për qëndrueshmërinë e tyre financiare të nevojshme me anë të deklaratave bankare.

4. Nuk është i besueshëm për qëllime të sigurisë së informacionit të klasifikuar, një operator ekonomik i cili:

4.1. Rezulton se gjatë 10 (dhjetë) viteve të fundit i është hequr CSI për shkelje të rregullave të sigurisë së informacionit të klasifikuar, ose ka shkelur rregullat e sigurisë në kushtet e prokurimit të një kontrate/nëkontrate e cila përmban informacion të klasifikuar;

4.2. Gjatë aplikimit për pajisje me CSI ka ofruar informacion të rremë dhe dokumente të rreme apo ka fshehur informacion lidhur me aspektet e verifikimit të sigurisë;

4.3. Rezulton se disponon të ardhura të siguruara nga veprimtaritë kriminale apo të pajustificuara, referuar mospërputhjes së kapitalit dhe pronës dhe të ardhurave të deklaruara rregullisht prej tij;

4.4. Rezulton se është në ortakëri, ose marrëdhënie të ngushta biznesi me persona, në adresë të të cilëve janë referuar të dhëna të vërtetuara ose dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprimtari spiunazhi, terrorizmi, krimi të organizuar, korrupsioni, apo të çdo forme tjetër kërcënuese për sigurinë kombëtare;

4.5. Pronari/pronarët, administratori, rezultojnë të dënuar për veprimtari kriminale, ose me të dhëna të vërtetuara apo dyshime të arsyeshme për përfshirjen e tyre në veprimtari spiunazhi,

terrorizmi, krimi të organizuar, korrupsioni, apo të çdo forme tjetër kërcënuese për sigurinë kombëtare;

4.6. Refuzon marrjen e masave të rekomanduara nga AMIK për uljen deri në kufijtë e pranueshëm të rrezikut të sigurisë nga potenciali i influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja, sipas nenit 19 të kësaj Rregulloreje.

Neni 19

Kriteret për vlerësimin e ndikimit dhe të influencës së huaj

1. Pronësia e huaj, si formë kontrolli apo influence i referohet një situatë, kur individualisht një palë e tretë e huaj, person, operator ekonomik apo qeveri, vlerësohet që posedon ndikim apo autoritet mbi një operator ekonomik vendor, në një shkallë të tillë, ku pala e tretë mund të përfitojë qasje tek informacioni i klasifikuar.

2. Vlerësimi i influencës së huaj synon të identifikojë shkallën aktuale ose potencialin e influencës së mundshme, të ushtruar për llogari të interesave të huaja, përmes së cilës synohet qasje e paautorizuar në informacionin e klasifikuar.

3. AMIK kryen vlerësimin e influencës së huaj, referuar:

3.1. pronësisë apo shumicës së aksioneve në pronësi;

3.2. pozitave të administratorit, të stafit menaxherial apo të personelit në pozita kyçe në veprimtarinë e operatorit ekonomik të interesuar.

4. Një operator ekonomik mund të vendoset nën ndikimin e influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja, kur rezulton se një interes i huaj ka fuqi, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, qoftë të ushtruara apo jo, për të drejtuar ose për të vendosur për çështje që prekin menaxhimin ose operacionet e operatorit ekonomik, në një mënyrë që mund të rezultojnë në qasje të paautorizuar ose mund të ndikojnë negativisht në përmbushjen e kontratave që përmbajnë informacion të klasifikuar.

5. Konsiderohet se është nën potencialin e mundshëm të influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja:

5.1. Çdo operator ekonomik vendor, i cili ka në pozitën e administratorit, anëtarit të stafit menaxherial apo të pozitave kyçe të drejtimit dhe të mbikëqyrjes së veprimtarisë së tij, të personave, të cilët kanë shtetësinë e vendeve që nuk janë anëtarë të NATO-s, BE-së apo të një shteti me të cilin Republika e Kosovës nuk ka Marrëveshje të Sigurisë.

6. AMIK shqyrton matricën e vlerësimit lidhur me potencialin e influencës së mundshme të ushtruar për llogari të interesave të huaja, duke shfrytëzuar nivelet e pronësisë apo të shumicës së aksioneve që ato kanë në pronësi për çdo operator ekonomik të interesuar.

7. AMIK në bashkëpunim me operatorin ekonomik të interesuar, përdorin masa sigurie kufizuese dhe mbrojtëse për uljen deri në kufij të pranueshëm të rrezikut të sigurisë nga potenciali i influencës së

ushtruar për llogari të interesave të huaja, të cilat në tërësinë e tyre synojnë për të parandaluar qasjen e paautorizuar tek informacioni i klasifikuar.

Neni 20

Vlerësimi i rrezikut të papranueshëm të sigurisë

1. AMIK kryen vlerësimin e rrezikut të papranueshëm të sigurisë të operatorit ekonomik, përpara lëshimit të CSI-së.
2. Vlerësimi i rrezikut të papranueshëm të sigurisë, kryhet bazuar në:
 - 2.1. Informacionet e përfituara dhe verifikimet për operatorin ekonomik që do të pajiset me CSI dhe kategoritë e personave që do të pajisen me CSP;
 - 2.2. Raportin e inspektimit paraprak të zyrave qendrore të operatorit ekonomik, lidhur me aftësitë dhe kapacitetet teknike, fizike dhe ato për sigurinë e informacionit të klasifikuar, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi.
 - 2.3. Vlerësimin lidhur me shkallën e ndikimit të potencialit të mundshëm të influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja dhe të masave të kufizimit të rrezikut të sigurisë;

Neni 21

Lëshimi i CSI-së

1. AMIK kryen lëshimin e CSI për operatorin ekonomik, kur vlerëson se:
 - 1.1. Nuk ekziston rrezik i papranueshëm për sigurinë e informacionit të klasifikuar;
 - 1.2. Operatori ekonomik i interesuar, posedon aftësinë dhe kapacitetet teknike për sigurinë e informacionit të klasifikuar, sipas kërkesave të parashikuara në këtë Rregullore dhe nga legjislacioni në fuqi.
2. Në rastin kur nuk lëshohet CSI, AMIK, njofton me shkrim institucionin apo strukturën që ka kërkuar pajisjen me CSI të operatorit ekonomik.
3. Lëshimi i CSI së një filiali apo dege të operatorit ekonomik, kryhet nga autoriteti kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar, i vendit ku filiali apo dega është regjistruar dhe pajisur me Numër Unik të Identifikimit (NUI).
4. Lëshimi i CSP për punonjësit e filialit apo degës së operatorit ekonomik kryhet nga autoriteti kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar të vendit, shtetësinë e të cilit ata mbajnë.

Neni 22

Heqja e CSI-së

1. AMIK, merr vendimin për heqjen e CSI, në rastet kur:

1.1. Përmes autoriteteve kontraktuese, ose inspektimeve të kryera, pranon raporte zyrtare, informacion të vërtetuar apo në kuadër të dyshimeve të arsyeshme, sipas të cilave, arrihet në përfundime të arsyetuara, se mbajtja e mëtejshme e CSI-së e lëshuar për një operator ekonomik, përbën rrezik të papranueshëm për sigurinë e informacionit të klasifikuar, referuar kërkesave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar;

1.2. Vërtetohet ekzistenca e rrethanave të parashikuara në paragrafin 2 e 4 të nenit 18 të kësaj Rregulloreje.

Neni 23

Pezullimi i përkohshëm i CSI-së

1. AMIK merr Vendimin për pezullimin e përkohshëm të CSI-së, kur konstatohet se:

1.1. Operatori ekonomik është nën potencialin e mundshëm të influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja, deri në marrjen e masave të kufizimit të rrezikut të sigurisë;

1.2. Janë konstatuar shkelje të rregullave të sigurisë ose mos përmbushje e detyrimeve të parashikuara në Udhëzuesin e Sigurisë së Projektit;

1.3. Janë siguruar informacione apo raporte zyrtare, sipas të cilave krijohen dyshime që duhen konfirmuar, se mbajtja e mëtejshme e CSI-së e lëshuar për një operator ekonomik, përbën rrezik të papranueshëm për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

2. Vendimi mbi pezullimin e CSI-së, është i vlefshëm deri në momentin e sqarimit të fakteve apo pushimit të rrethanave, që përbëjnë rrezik të papranueshëm për sigurinë e informacionit të klasifikuar, ose deri në momentin kur CSI-së i mbaron afati i vlefshmërisë së saj.

Neni 24

Detyrimet e AMIK-ut kur heq apo pezullon CSI

1. AMIK, në çdo rast kur heq apo pezullon përkohësisht CSI, për marrjen e Vendimit, informon:

1.1. autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë të përfshirë në përmbushjen e një kontrate të klasifikuar si dhe, kur është e zbatueshme, autoritetin kompetentet përgjegjës për sigurinë e informacionit të një vendi tjetër;

1.2. Autoritetin kompetentet përgjegjës për sigurinë e informacionit të një vendi tjetër, kur operatori ekonomik ndaj të cilit është marrë masa e pezullimit apo revokimit të CSI, është palë në një kontratë/nëkontratë ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, e cila përmban informacion të klasifikuar.

2. Informacioni i njoftimit përfshin arsyetimin ligjor lidhur me pezullimin e përkohshëm apo heqjen e CSI-së, kur ai nuk përmban informacion të klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 25 **E drejta e Ankesës**

1. Operatorit ekonomik të cilit i është refuzuar, pezulluar apo hequr Certifikata e Sigurisë Industriale ose Certifikata e Sigurisë Personelit ka të drejtë të ushtrojë ankesë pranë AMIK-u brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të njoftimit.

2. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave sipas Rregullores për Procedurat e Verifikimit të Sigurisë së Personelit dhe Procedurën e Ankesës.

Neni 26 **Lëshimi dhe përshtatja e CSP-së për punonjësit e operatorit ekonomik**

1. Procedurat për lëshimin, heqjen, pezullimin dhe refuzimin e pajisjes me CSP dhe çdo aspekt tjetër për sigurinë e personelit të operatorëve ekonomik të interesuar, realizohet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

2. Në rastet kur një person, i cili posedon një CSP dhe është në dy apo më shumë vende pune apo transferohet në një vend pune tek një operator ekonomik i pajisur me CSI ose në një institucion shtetëror, institucioni shtetëror apo operatori ekonomik duhet të njoftojë AMIK-un e cila bënë përshtatjen me pozitën e re që mban.

Neni 27 **Detyrat e autoriteteve doganore, policore dhe të institucioneve të tjera**

1. Autoritetet Doganore, të Policisë së Kosovës dhe sipas rasteve edhe të institucioneve të tjera shtetërore, pasi marrin njoftimin me shkrim nga autoriteti përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar, për detaje që lidhen me transportin e dërgesës së klasifikuar, marrin masa që:

1.1. Të angazhojnë punonjës të strukturave të tyre të pajisur me CSP të përshtatshme për kryerjen e procedurave përkatëse doganore e policore pa e ekspozuar informacionin e klasifikuar;

1.2. Doganieret, agjentet doganorë, punonjësit e policisë dhe çdo individ tjetër, që do të ketë qasje tek dokumentacioni shoqëruar i dërgesës së klasifikuar, nënshkruajnë dhe konfirmojnë njohjen e tyre me elemente të dërgesës së klasifikuar.

2. Autoritetet doganore, të policisë së shtetit dhe sipas rasteve edhe të institucioneve të tjera shtetërore, pasi plotësojnë detyrimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, shqyrtojnë dokumentacionin ligjor të transportit dhe kryejnë detyrat e tyre funksionale, duke garantuar sigurinë e dërgesës së klasifikuar.

2.1. Dokumentet e transportit, që janë pjesë përbërëse e dërgesës së klasifikuar nuk duhet që në asnjë rrethanë të ekspozohen si të tilla ndaj personave të paautorizuar.

2.2. Dokumentet e transportit shoqërohen me të dhëna rreth origjinës dhe destinacionit dërgesës së klasifikuar, parashikimin për kohën e mbërritjes, pajisjet shoqëruese për dorëzim nëse ka të tilla, të dhënat identifikuese të personit të palës pranuese të dërgesës së klasifikuar, etj.

3. Autoritetet doganore, të policisë dhe sipas rasteve edhe të institucioneve të tjera shtetërore, marrin masat përkatëse që administratorët e tyre, pavarësisht funksionit dhe detyrave që kryejnë, në asnjë rrethanë, të mos mbajnë në ruajtje në mjediset e tyre të punës dërgesën e klasifikuar.

4. Pala pranuese, përmes personit të autorizuar, konfirmon pranimin e dërgesës së klasifikuar, duke nënshkruar në dokumentacionin përkatës të transportit dhe sipas rastit edhe në dokumentacionin përkatës që mbajnë autoritetet doganore, të policisë dhe të institucioneve të tjera shtetërore.

Neni 28 **Transportimi**

1. Transportimi i materialit të klasifikuar jashtë zonës së sigurisë ose jashtë shtetit kryhet me mjete që plotësojnë kërkesat për sigurimin e informacionit të klasifikuar, siç përcaktohet në kontratën e klasifikuar.

2. Autoriteti kontraktues përcakton masat për sigurimin e materialit të klasifikuar që duhet të zbatohen në të gjitha etapat gjatë transportimit dhe në çfarëdo rrethane, nga pika e origjinës deri në destinacion. Transportimi nga ajri dhe deti bëhen në të njëjtat kushte të sigurisë sikurse transportimi nga toka.

3. Masat për sigurimin e materialit të klasifikuar që transportohet duhet të jenë në nivelin më të lartë.

4. Personeli, që transporton materialin e klasifikuar, duhet të ketë leje të përshtatshme të sigurisë.

5. Itinerari i kalimit përcaktohet në rrugë të sigurta, por, nëse duhet të kalohet nëpër qytete të mëdha, merren masa, që materiali të jetë jashtë çdo kërcënimi dhe krize.

6. Paketimi i materialit të klasifikuar bëhet me listë inventari, sipas nivelit të klasifikimit.

7. Materiali i klasifikuar transportohet në arka metalike të mbyllura ose në kontenierë, të siguar dhe nën mbikëqyrjen e së paku një punonjësi të sigurisë, si dhe të markuara e të vulosura. Kur transporti përfshin dy ose më shumë kontenierë, masat e sigurisë për secilin duhet të merren në përputhje me nivelin më të lartë të klasifikimit të materialit të klasifikuar, që transportojnë.

8. Në rrethana të jashtëzakonshme, materiali i klasifikuar transportohet vetëm me mjete speciale, shoqëruar me rojë të armatosura, në bashkërendim me njësitë përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme ose të Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ndalimi në vende të caktuara gjatë transportimit bëhet në përputhje me një plan të sigurisë, të parapërgatitur.

10. Në raste emergjence, aksidenti, prishjeje automjeti, katastrofe natyrore apo të ngjashme me to, materiali i klasifikuar ruhet gjatë të gjithë kohës së ndalesës në vendin e caktuar, nga rojet e sigurisë, të armatosura, dhe nga personat shoqërues.

11. Gjatë transportimit të materialit të klasifikuar mbahet komunikim i vazhdueshëm, me mjete dhe pajisje të certifikuara përshtatshëm.

12. Në kushtet e rrezikut në rritje për materialin e klasifikuar caktohen roja të sigurisë. Në varësi të vlerësimit të rrezikut konkret, mund të caktohen roje dhe civilë të armatosur. Personat e ngarkuar si rojë ose si persona shoqërues trajnohen dhe u jepen udhëzime të hollësishme se si ta trajtojnë materialin e klasifikuar.

Neni 29 **Vizitat**

1. Vizitat kryhen për qëllime të ligjshme dhe të autorizuara nga autoriteti kontraktues, kur parashikohet se materiali i klasifikuar do të paraqitet nga kontraktuesi i cili ka Certifikatë të Sigurisë përshtatshëm.

2. Vizitat caktohen gjatë një periudhe njëvjeçare. Vizitat që lidhen me kontratën e klasifikuar kryhen për sa kohë zgjat kontrata dhe me miratimin e autoritetit kontraktues. Numri i vizitave duhet të jetë sa më i vogël. Vizitat kategorizohen si në vijim:

2.1. Vizita të veçanta, me një qëllim të caktuar dhe kohëzgjatje deri në 30 ditë dhe që nuk përsëriten brenda vitit;

2.2. Vizita periodike, në periudha të caktuara kohore, brenda vitit;

2.3. Vizita urgjente, që kryhen për shkak të një çështjeje të një rëndësie të veçantë.

3. Vizitat kryhen tek autoriteti kontraktues ose te operatori ekonomik. Në rastet kur subjekt i vizitave është operatori ekonomik, ai njofton me shkrim autoritetin kontraktues dhe kërkon miratimin e tij për kryerjen e vizitës. Në raste urgjente, kërkesa për vizitë mund të bëhet gojarisht, me kusht që të shoqërohet, më pas, me shkrim, brenda 10 ditëve nga data e kryerjes së vizitës.

4. Përfaqësuesit e institucioneve publike, në zbatim të detyrave zyrtare, mund të vizitojnë operatorin ekonomik pa lajmërim paraprak, me kusht që këta përfaqësues të paraqesin lejen e sigurisë dhe dokumentet e identifikimit të pozitës zyrtare, si dhe autorizimin përkatës. Në vizitat e miratuara më parë, që nuk lidhen me kontratën e klasifikuar, informacioni i klasifikuar nuk ekspozohet pa miratimin paraprak të autoritetit kontraktues.

5. Vizitorëve u jepet qasje vetëm për informacionin e klasifikuar, që lidhet me qëllimin e vizitës dhe me domosdoshmërinë e njohjes me informacionin, pas pajisjes me certifikatë të sigurisë të përshtatshme.

6. Autorizimi i vizitës përmban:

6.1. Qëllimin dhe arsyen;

6.2. Nivelin e CSI-së, emrin e kontraktuesit, adresën, numrin e telefonit dhe adresën elektronike të tij;

6.3. Emrin, datën, vendlindjen dhe shtetësinë e personit, që kryen vizitën;

6.4. Vërtetimin e lejës së sigurisë dhe autorizimin për qasje të veçanta;

6.5. Emrat e personave, që do të kontaktohen;

6.6. Periudhën e vlefshmërisë së dokumenteve të autorizimit të vizitës.

6.7. Në çdo rast, personeli i sigurisë, i autorizuar, i operatori ekonomik mban protokollin e vizitave.

7. Në vizitat e miratuara më parë, që lidhen me kontratën e klasifikuar, materiali i klasifikuar mund të ekspozohet pa miratimin e autoritetit kontraktues, në rastet kur operatori ekonomik e gjen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

8. Vizitat nga përfaqësues të një pale të tretë bëhen vetëm me miratim paraprak të palëve, të përfshira në kontratën e klasifikuar.

Neni 30

Inspektimi i Operatorëve Ekonomik dhe nënkontraktuesve

1. Nëse gjatë inspektimit të operatorëve ekonomikë dhe nënkontraktuesve, AMIK gjenë se informacionet klasifikuara nuk ruhen konform planit të sigurisë së projektit, përpilon një raport lidhur me të gjeturat dhe i rekomandon drejtuesit të Institucionit Publik në cilësinë e autoritetit kontraktues për marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e sigurisë brenda zonave ku ruhet apo administrohet informacioni i klasifikuar dhe afatin kohor për zbatimin e rekomandimeve.

2. Institucioni publik të cilit i janë dërguar rekomandimet është i obliguar t'i ndërmerret të gjitha masat ndaj operatorit ekonomik apo nënkontraktuesit për përmirësimin e masave të sigurisë për zbatimin e rekomandimeve të AMIK-ut deri në shkëputjen e kontratës dhe për këtë duhet ta njoftojë AMIK-un.

3. Nëse gjatë inspektimit, AMIK vlerëson se shkelja e masave të sigurisë së informacioneve të klasifikuara ka elemente të veprës penale, njofton institucionin kompetent.

Neni 31

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregulloreja Nr. 15/2011, Standardet për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar për Operatorët Ekonomik.

Neni 32
Shtojca

Shtojcë e kësaj është Pyetëtori për Sigurinë Industriale.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

10 maj 2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

PYETËSORI I SIGURISË INDUSTRIALE

Udhëzues i Pyetësit të Sigurisë Industriale (PSI)

Lutemi zbatoni me kujdes udhëzimet e mëposhtme:

Përpara plotësimit, shqyrtoni me kujdes të gjitha rubrikat e PSI.

Plotësoni me informacion të plotë dhe saktë çdo rubrikë të PSI.

Administratori/përfaqësuesi i operatorit ekonomik shkruan të dhënat dhe nënshkruan çdo faqe të PSI në vendin e përcaktuar.

Në rubrikat ku, administratori/përfaqësuesi i operatorit ekonomik nuk ka informacion për të deklaruar, plotëson “Jo e aplikueshme”

1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR OPERATORIN EKONOMIK

a. Emri i Operatorit Ekonomik (OE):

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

b. Numri Unik Identifikues (NUI):

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

c. Numri Fiskal:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

d. Forma Ligjore e Organizimit:

Biznes Individual

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara

Shoqëri Aksionare

Ortakëri e Kufizuar

Ortakëri e Përgjithshme

																				Tjetër:
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	---------

e. Vendi i themelimit:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

f. Data e themelimit / regjistrimit:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

g. Adresa selisë:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

h. Adresa e degëve (nëse ka):

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

i. Të dhënat e kontaktit të OE:

j. Nr. Telefonit:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

k. E-mail adresa:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

l. website OE:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

ll. Numri i punonjësve aktual:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

m. Numri i punonjësve që do të pajisen me CSP:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

2 PARAQISNI STRUKTURËN E BRENDSHME ORGANIZATIVE të OE (organogramin)

a. Specifikoni departamentet dhe personelin përkatës përfaqësues

3 PARAQISNI ORGANOGRAMIN QË TREGON PRONËSINË E OPERATORIT EKONOMIK DHE MARRËDHËNIEN E TIJ ME OPERATOR EKONOMIK TË TJERË LIDHUR

a. Specifikoni emrat dhe adresat e OE të lidhur:

4 JEPNI TË DHËNA PËR ANËTARËT E STAFIT MENAXHERIAL TË OE NË TRE (3) VITET E FUNDIT

ndjes	Nr. Personal	Shtetësia	Pozita-Funksioni	Fillimi - Mbarimi	Arsyeja e largimit

e. Listoni bashkëpronarët e OE gjatë tre (3) viteve të fundit?

Bashkëpronar sipas periudhës kohore	Përqindja e aksioneve	Mënyra e lëshimit të aksioneve <i>(nëse është aplikuar)</i>	Larguar ose jo

f. Jepni informacion financiar bazuar në bilancet e OE për tre (3) vitet e fundit të aktivitetit?

	Viti:	Viti:	Viti:
Të ardhurat:			
Shpenzimet:			
Fitimi:			
Humbjet:			

g. A posedon aksione OE, drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet shoqërive të kontrolluara (*filialeve*) dhe/ose degëve të tij pjesë në kapitalin vendas?

PO

JO

Nëse Po, jepni të dhëna:

Në cilin OE:

Përqindja e aksioneve:

Datën që kur i posedon aksionet:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

h. **A posedon aksione OE drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet shoqërive të kontrolluara (filialeve) dhe/ose degëve të tij, pjesë në kapital të huaj?**

PO

JO

Nëse Po, jepni të dhëna:

Emri i OE të huaj:

Vendi i regjistrimit të OE të huaj:

Përqindja e aksioneve në posedim të OE të huaj:

Datën që kur zotërohet ky kapital:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

i. **A ka ndonjë individ apo OE i huaj, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, pronësi në OE tuajin?**

PO

JO

Nëse Po, jeni të dhëna:

Gjeneralitetet e individit (emër, mbiemër, datëlindje, Nr. Personal) apo të dhënat e OE të huaj:

Vendin e regjistrimit të OE të huaj/shtetësinë e individit të huaj:

Pjesa e kapitalit që zotëron OE i huaj/individit i huaj, të shprehur në përqindje:

Datën që kur zotërohet ky kapital:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Mënyrën e përfitimit të kapitalit të zotëruar nga OE i huaj/individ i huaj:

- j. **A mendoni se ndonjë individ apo OE i huaj ka mundësi të kontrolloj ose ndikojë në operacionet apo sferën e menaxhimit të OE?** PO JO

Nëse Po, jepni të dhëna:

Gjeneralitetet e individit (emër, mbiemër, datëlindje, Nr. Personal), apo të dhënat e OE të huaj:

Mënyra e ndikimit/kontrollit të huaj:

- k. **A ka OE investime financiare të tjera, të ndryshme nga pronësia (si: huadhënie, garancione etj) në OE të tjerë?** PO JO

Nëse Po, jepni të dhëna:

Emri i OE dhe vendin e regjistrimit:

Llojin e investimit dhe vlerën monetare:

Datën kur është investuar:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

- l. **A ka realizuar OE të ardhura nga individ apo OE të huaj dhe/ose kontrata (kontakte, marrëveshje) me persona apo OE të huaj gjatë tre (3) viteve të fundit?** PO JO

Nëse Po, jepni të dhëna lidhur me to:

Gjeneralitetet e individit (emër, mbiemër, datëlindje, Nr. Personal) ose të dhënat e OE të huaj nga realizohen të ardhurat:

Qëllimi i kontratës/marrëveshjes:

Data kur është lidhur kontrata/marrëveshja:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Përqinjda në të ardhura totale të OE, e cila është përfituar nga individ/ OE i huaj:

- ll. **A ka OE ndonjë borxh financiar apo detyrim ndaj individëve ose OE të huaj?** PO JO

Nëse Po, jepni të dhëna lidhur me të:

Gjeneralitetet e individit (emër, mbiemër, datëlindje, Nr. Personal) ose të dhënat e OE të huaj:

Llojin e borxhit/detyrimit:

Vlerën e borxhit/detyrimit:

Periudhën dhe detyrimet e shlyerjes së borxhit/detyrimit

Kolaterali i përdorur:

Nëse shlyerja e borxhit/detyrimit është realizuar, ose po realizohet sipas kushteve të përcaktuara:

Procedurat e parashikuara për t'u ndjekur në rast vonese të shlyerjes së detyrimit:

Sqaroni: Nëse ka ndikim borxhi apo detyrimi mbi pasuritë aktuale të kompanisë dhe aktivitetin e saj:

6 INFORMACION MBI AKTIVITETIN E OPERATORIT EKONOMIK

a. A ka marrë pjesë OE në prokurime publike në tre (3) vitet e fundi

PO

JO

Nëse Po, sqaroni:

b. A ka realizuar OE kontrata publike gjatë tre (3) viteve të fundit:

PO

JO

Nëse Po, jepni të dhëna për çdo kontratë publike si më poshtë:

Emrin e autoritetit kontraktor:

Qëllimin e prokurimit:

Data e lidhjes së kontratës/kontratave:

Data e realizimit të kontratës/kontratave:

c. Gjatë tre (3) viteve të fundit, a është përjashtuar OE nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik? (Vërtetuar me dokumentacion përkatës origjinal lëshuar nga autoriteti kompetentë)

PO

JO

Nëse Po, jepni të dhënat:

d. **A ndodhet OE në fazën e ndonjë procedure administrative?**

PO

JO

Nëse Po, jepni të dhëna:

Emrin e autoritetit kontraktor:

Qëllimin e prokurimit:

Arsyeja e procedimit:

e. **Gjatë tre (3) viteve të fundit, a është përjashtuar OE nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë? (Vërtetuar me dokumentacion përkatës të lëshuar nga autoriteti kompetent)**

PO

JO

Nëse Po, sqaroni:

f. **A ka marrë pjesë gjatë tre (3) viteve të fundit OE në prokurime në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmbajnë informacion të klasifikuar**

PO

JO

Nëse Po, jepni të dhëna:

g. **A ka realizuar gjatë tre (3) viteve të fundit OE kontrata prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurië, që përmbajnë informacion të klasifikuar?**

PO

JO

Nëse Po, jepni të dhënat për çdo kontratë prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmbajnë informacion të klasifikuar si më poshtë:

Emrin e autoritetit kontraktor:

Qëllimin e prokurimit:

Nivelin e klasifikimit:

Data e realizimit të kontratës/kontratave (shoqëruar me vërtetimet e realizimit të kontratës/kontratave)

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

h. Gjatë tre (3) viteve të fundit, a ka zhvilluar OE kontrata me kompani të tjera? PO JO

Nëse Po, jepni sqarime:

i. A ndodhet OE në fazën e ndonjë procedure administrative ose gjyqësore për mosrealizim kontrate me persona fizik apo juridik? PO JO

Nëse Po, sqaroni:

Të dhëna për paditësin dhe datën e padisë:

Qëllimin e kontratës për të cilën jeni paditur:

Institucioni që e ka në shqyrtim:

7 INFORMACION MBI SIGURINË E OPERATORIT EKONOMIK

a. A është OE i përfshirë në bashkëpunim biznesi me person/a apo subjekte ligjore për të cilët ju keni të dhëna se kanë pasur përfitime të pa ligjshme? PO JO

Nëse Po, jepni të dhëna për:

Gjeneralitetet e individit (emër, mbiemër, datëlindje, Nr. Personal) / emrin e subjektit

Vendin e regjistrimit:

Mënyrën e bashkëpunimit:

Datën e bashkëpunimit:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

b. A ka filluar ndonjë çështje gjyqësore ndaj OE, për shkak të ndonjë

PO JO

veprimtarie të pa ligjshme?

Nëse Po, jepni të dhëna për:

Arsyen e fillimit:

Kush e ka inicuar:

Në cilën gjykatë:

Datën fillimit:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

c. **A keni të dhëna për konflikt interesi brenda OE në lidhje me pronësinë/bashkëpronësinë**

PO

JO

Nëse Po, jepni të dhëna për:

Gjeneralitetet e individit (*emër, mbiemër, datëlindje, Nr. Personal*)/ *Emrin e OE:*

Llojin e konfliktit:

Datën e fillimit:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

d. **A ka OE të punësuar individ me shtetësi të huaj?**

PO

JO

Nëse Po, jepni të dhënat për:

Emri:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Mbiemri:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Gjinia

M

F

Data e lindjes:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Vendi i lindjes:

Kombësia / Shtetësia:

Adresa e banimit:

Kontaktet, nr. Tel, e-mail

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Niveli i kërkuar i CSP

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Kategoria e informacionit në të cilin do të ketë qasje (*shtetëror, BE apo NATO*)

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Fotokopje e pasaportës

e. A kontraktton OE individ apo OE të huaj për qëllim të mbështetjes së aktivitetit të tij?

PO

JO

Nëse Po, specifikoni për tre (3) vitet e fundit

Gjeneralitetet e individit (*emër, mbiemër, datëlindje, Nr. Personal / operatorit ekonomik*)

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Vendin e regjistrimit:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Qëllimin për të cilin është kontraktuar:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

f. A është ndonjë anëtar i personelit të OE tuaj (*staf menaxherial ose teknik*) i punësuar apo që shërben si konsulent për ndonjë individ apo OE të huaj?

PO

JO

Nëse Po, specifikoni për tre (3) vitet e fundit:

Gjeneralitetet e individit (*emër, mbiemër, datëlindje, Nr. Personal*) në kompani:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Emrin dhe vendin e regjistrimit të individit apo kompanisë së huaj ku është i punësuar:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Pozita apo Funkcioni që ka në kompaninë e huaj:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

8 INFORMACION MBI ZYRTARIN E SIGURISË INDUSTRIALE

Emri (emër tjetër i përdorur):

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Mbiemri (mbiemër tjetër i përdorur):

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Data e lindjes:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Vendi i lindjes:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Nr.: Personal:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Shtetësia (përfshirë të mëparshmen):

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Nr.: Kontaktit:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

9 LISTA E PERSONAVE QË DO TË PAJISEN ME CERTIFIKATË TË SIGURISË SË PERSONELIT

	Emri dhe mbiemri	Datëlindje	Nr. telefoni	Pozita/Funksioni	Vërejtje
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					

Deklaratë

Në cilësinë e administratorit të OE: _____, duke plotësuar dhe nënshkruar këtë pyetësor, jap pelqimin tim, që autoritetet e sigurisë, inteligjencës dhe ligjzbatuese të kontrollojnë dhe përpunojnë informacionin e deklaruar në këtë dokument, si dhe të ndërmarrin procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për zbatimin e verifikimit të sigurisë së Operatorit Ekonomik: _____.

Jam dakord që të aplikohen procedurat e verifikimit nga autoritetet publike, të cilat me aktet normative në fuqi janë të ngarkuara për të kryer një detyrë të tillë.

Jam dakord që Operatori Ekonomik: _____, të inspektohet nga AMIK në funksion të procedurës së pajisjes me Certifikatë të Sigurisë Industriale dhe në vijim gjatë gjithë afateve të vlefshmërisë së saj.

Në cilësinë e administratorit/përfaqësuesit të OE, marrë përsipër me përgjegjësi të plotë, të ruaj dhe administroj informacionin e klasifikuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.